**PROCES VERBAL**

Mbajtur sot me datë: 26.10.2022, ora 17:00 në Njësinë Administrative Suç, për hartimin e projekt- buxhetit 2023 dhe Paketës Fiskale 2023.

Marrin pjesë: Kryetari i Bashkisë, Nënkryetarja e Bashkisë, Administratori i Njësisë Administrative Suç, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike dhe shërbimeve Financiare, Përgjegjësja e Sektorit të financës e banorë të NJ.Adm. Suç.

Hap mbledhjen Kryetari i Bashkisë duke falenderuar banorët që marrin pjesë në takim dhe duke treguar arsyen për të cilën jemë mbledhur, për të marrë mendime dhe kërkesa në lidhje me hartimin e buxhetit dhe paketës fiskale të vitit 2023 si dhe PBA 2023-2025.

Kryetari shpjegon financimin e Bashkive që realizohet nga transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar, transferta sektoriale & nga të ardhurat e mbledhura.

Kryetari shpjegon që të ardhurat e mbledhura zënë një përqindje shumë të vogël në buxhet duke kushtëzuar kështu planifikimin dhe realizimin e investimeve me vlerë të larta.

Tregon diferencën e transfertës së pakushtëzuar nga viti 2022 në vitin 2023 & thotë që me buxhetin që kemi në dispozicion bëhen vetëm punë të vogla, si rrugën nga xhamia te unaza.

Kryetari shpjegon që jemi mbledhur për të marrë kërkesat më primare të banorëve.

Merr fjalën Nënkryetari i Bashkisë i cili shpjegon që është lidhur kontrata dhe ka nisur azhornimi i tokave të fshatit Suç, është bërë punë e mirë dhe për vaditjen gjatë sezonit të verës.

Nënkryetari i Bashkisë paraqet shqetësim në lidhje me disa rrugë te Budini, te malorja në Shkorsë, malorja te lagjia Kadiu dhe në Kurgelaj te ura.

Marrin fjalën banorët e Zonës:

Flamur Keçi ka pyetje në lidhje me buxhetin që është harxhuar për fshatin Suç gjatë vitit 2022.

Kryetari i Bashkisë sqaron banorin se për fshatin Suç është harxhuar buxhet rreth 3.000.000 lekë për azhornimin e tokave të Suçit, është harxhuar pë

Koshat e mbetjeve, për pastrimin e mbeturinave, për pagat e punonjësve të vaditjes, ujësjellësit, ambjentin me qena të kopshtit etj.
Flet Rruti (Banon i fshatit Kujtim)
Ka ankesë për shtimin e koshave të mbeturinave dhe në lidhje me shtrimin e rrugëve me çakull.
Kryetari sqaron që janë shtruar me çakull të gjitha rrugët deri në Kurgelë.
Flet Rexhep Kuleni & falenderon për punët e bëra dhe për rezervuarin e Kurdarisë.
Avni Lata ka kërkesë se kur do bëhet azhornimi (matja) e tokave dhe si gjithmonë paraqet shqetësim për shkollën e Suçit.
Nënkryetari shpjegon që për azhornimin e tokave është lidhur kontrata dhe po vazhdon matja.
Flet Liman Laçi (banon i fshatit Suç)
Falenderon kryetarin për punët e bëra në vitin 2022.
Ka kërkesë për rrugën (unazën në Suç) & për pastrimin e kanaleve kulluese, për shkollën e Suçit & për rubineta te kanali i klosit.
Ai jep një mendim për të ulur nr. e stafit në Institucion.
-Baftjar Ka shqetësim në lidhje me mënyrën sesi do të realizohet azhornimi i tokave.
Kryetari shpjegon që gjithçka do të bëhet me transparencë, me objektivitet & me paanësi.

**Drejtor i B. Njerëzore, Ç. Juridike dhe Sh. Financiare**

Enduina Neli

Përgjegjëse e Financës

Silvana Bala

2022